

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 335, Datë 18.12.2025

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2825/2 prot., datë 16.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 81, datë 09.06.2016, dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 134, datë 07.06.2021, me afat vlefshmërie deri më 10.06.2026.
- Ajo ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2825/1 prot., datë 10.12.2025.
- Në nenin 16, pika 1, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 343, Seria F16/F21, është 10.06.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 10.12.2025.
- Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të Rregullores.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Shoqëria ka deklaruar se nuk ka ndryshime në dokumentacion nga momenti i licencimit, por duke marrë në konsideratë se dokumentacioni i licencimit i referohet dhe informacioneve/dokumentacioneve që duhet të rifreskohen për shkak të natyrës së përkohshme

të tyre, vlerësohet që t'i kërkohej të përditësojë informacionin/dokumentacionin, në vijim:

- *Dëshmitë e penalitetit për administratorin dhe vetë shoqërinë.*
- *Vërtetimet mbi shlyerjet e detyrimeve ndaj organeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.*
- *Sasinë e energjisë që shoqëria parashikon të furnizojë 5 vitet e ardhshme, planin e biznesit dhe mbështetjen financiare përkatëse.*
- *Mënyrën e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit.*
- *Sistemin IT për faturimin.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 343, Seria F16/F21, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 81, datë 09.06.2016, dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 134, datë 07.06.2021.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrît AHMETI